



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/69  
Datë: 15.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Në Ministrinë e Drejtësisë, në nën-programin Shërbimi Korrektues i Kosovës, me kod 33600, ndahen mjete në shumë deri në 309,600 € (treqind e nëntëmijë e gjashtëqind euro), në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa", për pagesën e shtesave për gardianet për dy muajt mars dhe prill 2021, për angazhimin e shtuar në punë dhe të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj pandemisë COVID-19. Shtesa në page sipas këtij paragrafi paguhet për 1548 përfitues për secilin muaj veç e veç në vlerë deri në 100 € (njëqind euro) për muaj për person sipas listës së përfituesve të dorëzuar nga Ministria e Drejtësisë në Thesar, me të gjitha të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit. Lista e përfituesve sipas këtij vendimi aprovohet nga ZKA dhe ZKF i Ministrisë së Drejtësisë, dhe dorëzohet me shkresë përcjellëse në Thesarin e Kosovës, për procesim përmes Sistemit të pagave.
2. Në organizatën buxhetore Zyra e Kryeministrit, në nën-programin Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), me kod 40800, në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa", ndahen mjete në shumë deri në 15,200 € (pesëmbëdhjetë mijë e dyqind euro) për pagesën e shtesave për inspektorët për dy muajt mars dhe prill 2021, për angazhimin e shtuar në punë dhe të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj pandemisë COVID-19. Shtesa në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për 76 përfitues për secilin muaj veç e veç në vlerë deri në 100 € (njëqind euro) për muaj për person sipas listës së përfituesve të dorëzuar nga AUV, me të gjitha të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit. Lista e përfituesve sipas këtij vendimi aprovohet nga Drejtori Ekzekutiv i AUV, dhe dorëzohet me shkresë përcjellëse në Thesarin e Kosovës, për procesim përmes Sistemit të pagave.
3. Në Ministrinë e Financave, në nën-programin Dogana e Kosovës, me kod 13300, ndahen mjete në shumë deri në 74,000 € (shtatëdhjetë e katërmijë euro), për pagesën e shtesave për inspektorët për dy muajt mars dhe prill 2021, për angazhimin e shtuar në punë dhe të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj pandemisë COVID-19. Shtesa në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për 370 përfitues për secilin muaj veç e veç në vlerë deri në 100 € (njëqind euro) për muaj për person sipas listës së përfituesve të dorëzuar nga Dogana e Kosovës, me të gjitha të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit. Lista e përfituesve sipas këtij vendimi aprovohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës, dhe dorëzohet me shkresë përcjellëse në Thesarin e Kosovës, për procesim përmes Sistemit të pagave.




4. Në Ministrinë e Financave, në nën-programin Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me kod 11600, ndahen mjete në shumë deri në 81,800 € (tetëdhjetë e njëmijë e tetëqind euro), për pagesën e shtesave për inspektorët për dy muajt mars dhe prill 2021, për angazhimin e shtuar në punë dhe të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj pandemisë COVID-19. Shtesa në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për 409 përfitues për secilin muaj veç e veç në vlerë deri në 100 € (njëqind euro) për muaj për person sipas listës së përfituesve të dorëzuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, me të gjitha të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit. Lista e përfituesve sipas këtij vendimi aprovohet nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK, dhe dorëzohet me shkresë përcjellëse në Thesarin e Kosovës, për procesim përmes Sistemit të pagave.
5. Mjetet për zbatimin e pikave 1-4 të këtij Vendimi ndahen nga nën-programi "Programi për Rimëkëmbje Ekonomike (MF)" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Paga dhe shtesa" dhe ndahen në përputhje me të dhënat si në paragrafët 1-4 të këtij vendimi.
6. Autorizohet Ministria e Financave që pas pranimit të listave përfundimtare sipas pikave 1-4 të këtij vendimi, të bëjë ndarjen buxhetore për dy muaj të OB përkatës, në nën-programin buxhetor përkatës në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa", ndërsa alokimi i mjeteve bëhet çdo muaj, bazuar në çekun e përlllogaritur të pagave së bashku me shtesat përkatëse nga pikat 1-4 e vendimit.
7. Në rast se listat përfundimtare sipas pikave 1-4 të këtij vendimi procedohen në Thesar me vonesë, jashtë afatit për procedimin e ndryshimeve në Sistemin e Pagave, të njëjtat shtesa procedohen me pagën vijuese, si pagesë retroaktive e shtesës.
8. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë Nr. 08/65, datë 18.02.2021, si vijon:
  - 8.1. Reformulohet teksti i paragrafit 1. të Vendimit të Qeverisë nr. 08/65 të datës 18.02.2021, bazuar në listën faktike të aprovuar dhe ekzekutuar, si vijon: "Teksti në pikën 1.2, masa 2 e Vendimit të Qeverisë nr. 06/58 të datës 14.01.2021 riformulohet në si vijon: "Për sektorin e arsimit ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë 2,950,400 € (dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind euro) për pagesën e shtesës së parë për mësimdhënësit dhe personelin teknik/administrativ në sistemin para universitar për angazhimin e shtuar dhe të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj pandemisë COVID-19. Shtesa e parë në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për muajin shkurt 2021 në vlerë 100 € (njëqind euro) për person. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) konstaton përputhshmërinë me kriteret e këtij vendimi dhe aprovon pagesën e shtesave nga lista e sistemit të pagave, me shkresë përkatëse nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës kërkohet ekzekutimi i shtesave në Thesarin e Kosovës, përmes Sistemit të pagave. Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, ndahen mjete në shumë 2,000,000 € (dy milion euro) për mbështetjen e sektorit të arsimit për të mundësuar mbarëvajtjen e mësimin gjatë vitit shkollor 2020/21."
  - 8.2. Reformulohet teksti i paragrafit 3. të Vendimit të Qeverisë nr. 08/65 të datës 18.02.2021, bazuar në listën faktike të aprovuar dhe ekzekutuar si vijon: "Për sektorin e emergjencave, përkatësisht Zjarrfikësit, ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë totale 151,800 € (njëqind e pesëdhjetë e njëmijë e tetëqind euro), për pagesën e shtesave për zjarrfikësit aktiv për angazhimin e shtuar në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj pandemisë COVID-19. Shtesa në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për dy muajt shkurt dhe mars 2021 për secilin muaj veç e veç nga 100 € (njëqind euro) në muaj për person sipas listës së përfituesve të dorëzuar në Thesar nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave (AME) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), me të gjitha të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit. Komunitat dhe AME (MPB) janë përgjegjëse të përgatisin dhe të aprovjnë me shkresë përmes ZKA dhe ZKF të OB-ve listat e përfituesve të shtesës në pagë dhe të njëjtat përcillen në AME (MPB), të cilat pasi konstatohet përputhshmëria me kriteret e këtij



vendimi nga AME (MBP), me shkresë të veçantë dërgohen në Thesar, për procesim përmes Sistemit të pagave.”

9. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi Nr. 01/27 i datës 26.08.2020, paragrafi 2 dhe 3, dhe riformulohet si në vijim:
  - 9.1. Paragrafi 2 riformulohet si vijon: “Në pajtim me vendimin e qeverisë nr. 01/23 për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, lidhur me masën 11 të Programit, për realizimin e vitit shkollor 2020/21 në kushte pandemie dhe në zbatim të masave të përcaktuara në Master Plan ndahen mjete financiare në shumë prej 4,824,647 euro për vitin 2020; dhe
  - 9.2. Paragrafi 3 riformulohet si vijon: “Këto mjete ndahen për vitin 2020 si vijon: 3.1. Për MASH ndahen 1,864,647 euro dhe 3.2. Për komuna ndahen 2,960,000 euro.”
10. Pikat 8 dhe 9 të këtij vendimi, të zbatuara në muajin Shkurt 2021, kanë të bëjnë me disa riformulime dhe rregullime tekstuale dhe buxhetore, pa ndikime në ndarje shtese buxhetore.
11. Të gjitha pikat tjera të vendimit Nr. 08/65, datë 18.02.2021 si Vendimit Nr. 01/27 i datës 26.08.2020 mbeten të pandryshuara.
12. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave (Dogana, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Thesari) për zbatimin e këtij vendimi.
13. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/69

Datë: 15.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Ligjit Nr.07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID -19, Ligjit Nr. 07/L-006 Për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 06/58 të datës 14.01.2021, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen dhe alokohen mjetet financiare në vlerë prej 10,000,000.00 € (dhjetë milion euro), në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, në nën-programin Shërbimet Përkatëse Farmaceutike, me kod 71300, si vijon: (a) shuma prej 9,740,000 € (nëntë milion e shtatëqind e dyzet mijë euro) në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime" si dhe (b) shuma prej 260,000 € (dyqind e gjashtëdhjetë mijë euro) në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere".
2. Mjetet e ndara nga pika 1. e këtij vendimi në vlerë prej 260,000 € (dyqind e gjashtëdhjetë mijë euro) në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere", përdoren për angazhimin dhe pagesën për tre (3) muaj të stafit shëndetësor dhe mbështetës prej 210 pozitash, në përputhje me kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë.
3. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike (MF)" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbimeve.
4. Reformulohet pika 1.5.2 e Vendimit të Qeverisë me nr. 06/58 të datës 14.01.2021, si në vijim: Blerja e materialeve për menaxhimin e pandemisë COVID-19, aparaturave mjekësore si dhe angazhimin e personelit shëndetësor dhe mbështetës në shumë prej 10,000,000 € (dhjetë milionë euro).
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/69

Datë: 15.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 i Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Ligjit Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike, Vendimit të Qeverisë Nr. 06/58 të datës 14.01.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 03/64 të datës 12.02.2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjetet në shumë prej € 8,000,000 (tetë milion euro) për Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) me kod 213, në nën-programin "Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike" me kod 23300, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere".
2. Mjetet për zbatimin e pikës 1. të këtij Vendimi ndahen nga nën programi "Programi për Rimëkëmbje Ekonomike (MF)" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
3. Mjetet sipas pikës 1. të këtij vendimi nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit do t'i transferohen kompanisë publike "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut" - KOSTT Sh.a., me qëllim të pagesës për subvencionimin e tarifës për Burime të Ripërtërishme të Energjisë (BRE), në përputhje me Ligjin 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike dhe Vendimit Nr. 06/58 të datës 14.01.2021 sipas pikës 1.14, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 03/64 të datës 12.02.2021, e kufizuar me shumën e lejuar sipas pikës 1. të këtij vendimi.
4. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi Nr. 06/58, i datës 14.01.2021, pika 1.14, si dhe vendimi Nr. 03/64, i datës 12.02.2021, pika 1.1, ku nën-programi "Ndërmarrësia" zëvendësohet me nën-programin "Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike".
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HËTI**



\_\_\_\_\_  
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/69

Datë: 15.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjetet në shumë prej 500,000 € (pesëqindmijë euro) për Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS) me kod 207:
  - Në nën programin Përkrahja e Kulturës me kod 80500, shumë prej 300,000 € (tre qind mijë euro) në kategori të shpenzimeve subvencione dhe transfere dhe
  - Në nën programin Prezantimet dhe Kërkimet për Trashëgiminë Kulturore me kod 81600 shumë prej 200,000 (dyqindmijë euro) në kategori të shpenzimeve subvencione dhe transfere.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi do të shfrytëzohen për kryerjen e obligimeve financiare të cilat i ka MKRS në zbatim të vendimit Nr.12/38 të datës 30.10.2020 sipas planit të veprimit në të cilin janë përcaktuar kriteret për shpërndarjen e mjeteve buxhetore.
3. Mjetet për zbatimin e pikës 1. të këtij Vendimi ndahen nga nën programi "Programi për Rimëkëmbje Ekonomike (MF)" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/69

Datë: 15.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet kompensimi financiar i njëhershëm për delegatët e legjislaturës 1990 të cilët kanë certifikuar mandatin e deputetit në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës të datës 4 dhjetor 1999, të cilët kanë marrë pjesë në Mbledhjen e Kuvendit të Kosovës me datë 3 Korrik 1990 dhe me 7 shtator 1990 si dhe kanë vazhduar të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit deri më dt. 24 Maj 1992.
2. Mjetet financiar të përcaktuar në Ligjin Nr.07/ L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 në vlerë prej 287,000.00 euro, nga nën-programi Financimi i Deputetëve të Viteve 90-ta me kod 02100, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere do të ndahen proporcionalisht për njëqindesë (105) deputetë sipas Gazetës Zyrtare nr. 21 e datës 2.Korrik 1990, në shumë prej 2, 733 .00 euro për secilin deputet.
3. Për ata deputet që nuk janë në jetë, kompensimin e plotë financiare të njëhershëm, do e gëzojnë bashkëshortja/e veja e deputetit apo fëmija deri në moshën 18 vjeçare dhe nëse janë në studime deri në moshën 26 vjeçar, si është përcaktuar në pikën dy (2) të këtij Vendimi.
4. Çdo vendim për kompensimin e kësaj kategorie të përfituesve duhet të jetë i bazuar në ndarjen buxhetore të paraparë për këtë qëllim sipas Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.
5. Dokumenti në bazë të cilit vërtetohet numri dhe identiteti (emri e mbiemri) i deputeteve që gëzojnë kompensimin financiar të njëhershëm, sipas pikës një (1) të këtij Vendimi është Gazeta Zyrtare nr. 21 e datë 3.Korrik 1990.
6. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



\_\_\_\_\_  
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/69  
Datë: 15.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në zbatim të masës 6 të vendimit Nr. 06/58 date 14.01.2021, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Sindikatës së Lotarisë së Kosovës e datës 8 mars 2021, për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 40,000 € (dyzetmijë euro) për mbështetje financiare për punonjësit e saj.
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen dhe përdoren vetëm për mbështetje financiare (subvencionim) për punonjësit aktiv të Lotarisë, përjashtuar anëtarët e Bordit, ku secili punëtor duhet të përfitojë shumën e njëjtë - pa marrë parasysh sa është paga e tij/saj. Lotaria e Kosovës pas realizimit të pagesës sipas pikës 2. të këtij vendimi, njofton Ministrinë e Financave me shkrim, duke konfirmuar përmbushjen e kushtit ligjor sipas këtij vendimi.
3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga organizata buxhetore Ministria e Financave, nga nën-programi "Programi për Rimëkëmbje Ekonomike (MF), me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën-programi Thesari i Kosovës, me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfereve, të cilat transferohen nga Thesari në llogarinë përkatëse bankare të Lotarisë së Kosovës në një bankë komerciale.
4. Obligohet Ministria e Financave, Thesari dhe Lotaria e Kosovës për zbatimin e vendimit.
5. Obligohet Ministria e Financave në emër të Qeverisë që mjetet e dhëna nga pika 1. e këtij vendimi t'i trajtojë në përputhje me statusin e ardhshëm ligjor të Lotarisë së Kosovës, si kapital aksionar të Qeverisë apo si subvencionim, në pajtim me Vendimin e Qeverisë Nr. 19/111 datë 19.07.2019 si dhe Vendimit Nr. 04/37, datë 30.05.2020.
6. Obligohen organet drejtuese të Lotarisë së Kosovës Sh.A. që brenda 7 ditësh nga publikimi i këtij vendimi t'i raportojnë Qeverisë së Republikës së Kosovës për veprimet e ndërmarra në zbatim të pikës 6 të Vendimit Nr. 04/37, datë 30.05.2020, si dhe të vazhdojë të ndërmarrë veprimet e nevojshme që të mos krijohen obligime shtesë financiare nga data e marrjes së këtij vendimi dhe deri në zgjidhjen e statusit final të këtij institucioni, në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Lotarisë së Kosovës Sh.a.
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/69  
Datë: 15.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr.04/L-219 për të Huajt i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 06/L-036, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 09/09 të datës 01.07.2020**

1. Nryshohet dhe plotësohet pika 1.2, 1.4, 1.5, dhe 1.6 e Vendimit Nr. 09/09 të datës 01.07.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Komisionit të Ankesave për të Huajt, si në vijim:
  - 1.2. Kaltrina Nuhiu, Ministria e Drejtësisë - zv. Kryesues;
  - 1.4. Agim Krasniqi, Ministria e Arsimit dhe Shkencës - anëtar;
  - 1.5. Mehmet Morina, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - anëtar;
  - 1.6. Kaltrina Hyseni, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Anëtare;
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/69

Datë: 15.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Investime për financimin e projektit "Reagimi i Kosovës ndaj pandemisë Covid-19 për NVM-të".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/69  
Datë: 15.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Grantit në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkimi Evropian, i përfaqësuar nga Komisioni Evropian, për Projektin "Mbështetja e BE-së për disponueshmërinë dhe qasjen në vaksinat kundër COVID-19 në Kosovë".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/69  
Datë: 15.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Ligjit Nr.07/L-016 për Rimëkëmbje Ekonomike - COVID 19, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në zbatim të paragrafit 4 të nenit 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 për Shkollimin Specialistik, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesën e specializantëve me vetëfinancim, nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, prej datës 1 mars deri me datë 31 tetor 2021.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe institucionet tjera relevante, të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë